

Platforma e shkëmbimit në nivel ndërkombëtar për menaxhimin e mishngrënësve të mëdhenj në Rajonin Dinarik

Raporti mbi statusin dhe plani për hapat e ardhshëm



Autorë: Katrina Marsden, Andrea Solić, Đuro Huber, Julia Schmidt
Adelphi dhe Carnivora Magna, Qershor 2022

adelphi 
RESEARCH



Funded by the German Federal Environment Ministry's Advisory Assistance Programme (AAP)



Indeksi

| | |
|---|----|
| Historiku | 3 |
| Analiza e situatës bazë | 4 |
| Platforma | 4 |
| Aktivite për bashkëpunimin qeveritar/administrativ | 5 |
| Marrëveshja për bashkëpunim të vazhdueshëm | 7 |
| Bashkëpunim me aktorë të tjerë/aktivitetet në rajon | 9 |
| Shtojca 1. Anëtarët e Bordit Këshillimor | 11 |
| Shtojca 2. Pjesëmarrësit në takimet e platformës | 12 |

Cover picture © Huber 2022

Këto aktivitete janë financuar nga një projekt i menaxhuar nga «adelphi Research» dhe "Carnivora Magna"

Për më shumë informacion rreth projektit kontaktoni:

- dinaric.carnivores@adelphi.de

adelphi
RESEARCH



Ky projekt është financuar nga Ministria Federale Gjermane e Mjedisit, përmes Programit të Asistencës Këshillimore (AAP) për mbrojtjen e mjedisit në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, në Kaukaz dhe Azinë Qendrore, si dhe në vende të tjera fqinje të Bashkimit Evropian. Projekti është mbikëqyrur nga Agjencia Federale Gjermane për Ruajtjen e Natyrës (BfN) dhe nga Agjencia Gjermane e Mjedisit (UBA).



Federal Agency for
Nature Conservation

Informacione të mëtejshme: <https://www.umweltbundesamt.de/en/topics/sustainability-strategies-international/cooperation-eeca-centraleastern-european-states/project-database-advisory-assistance-programme/a-transnational-exchange-platform-for-the>

Historiku

Rajoni Dinarik në Ballkanin Perëndimor është një nga rajonet me larminë më të madhe biologjike në Evropë. Ky rajon është gjithashtu habitati i tri specieve mishngrënëse të mëdha: ariu, ujku dhe rrëqebulli (rrëqebulli i Ballkanit dhe i Euroazisë), që gjenden ndërmjet shteteve anëtare dhe joanëtare të BE-së.

Duke marrë parasysh larminë e madhe të këtyre specieve, sugjerohet koordinimi ndërkufitar për menaxhimin e tyre, për të mundësuar ruajtjen në një plan afatgjatë. Deri më sot, është ndërmarrë vetëm një numër i vogël nismash ndërkufitare për sa i përket tematikës së projektit, ndërmjet qeverive përkatëse.

Në vitin 2018, Platforma e BE-së për bashkekzistencën midis njerëzve dhe mishngrënësve të mëdhenj¹ - një grup organizatash që përfaqësonin interesa të ndryshme lidhur me ruajtjen dhe menaxhimin e mishngrënësve të mëdhenj - organizoi një seminar të përbashkët me partnerët në Budva të Malit të Zi². Në përfundim të seminarit, pjesëmarrësit nënshkruan një deklaratë të përbashkët³ në të cilën kërkohej krijimi i një platforme shkëmbimi në nivel ndërkufitar për menaxhimin e mishngrënësve të mëdhenj në Rajonin Dinarik. Këto objektiva bazohen në punën shumëvjeçare të ekspertëve të rajonit për krijimin e shkëmbimit/dialogut në nivel ndërkufitar. Kjo gjë tregon qartazi interesin e përfaqësuesve të shteteve, shkencëtarëve, OJQ-ve dhe grupeve të interesit në një qasje me pjesëmarrje midis vendeve.

Për të ndihmuar në përmbushjen e këtyre objektivave, një sërë aktorësh kanë punuar së bashku për ngritjen e Platformës Dinarike. Financimi fillestar është siguruar nga Agjencia Federale Gjermane për Mjedisin, përmes Programit të Asistencës Këshillimore (AAP) (Beratungshilfeprogramm)⁴. Objektivi kryesor i këtij financimi ishte ofrimi i kapacitetit njerëzor dhe financiar për krijimin e një platforme të shkëmbimit në nivel ndërkufitar dhe për përcaktimin e parimeve udhëzuese për bashkëpunim në të ardhmen, së bashku me administratat kombëtare në rajon (me Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Kroacinë, Kosovën*⁵, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbinë, Slloveninë si dhe me Greqinë dhe Bullgarinë).

Financimi fillestar ndihmoi në krijimin e proceseve të menaxhimit dhe shkëmbimit për të:

- Përforcuar njohuritë lidhur me praktikën dhe qëllimet e politikave të BE-së, në lidhje me menaxhimin e mishngrënësve të mëdhenj dhe përafrimin sa më të mirë të legjislacionit të BE-së për mjedisin, në veçanti të Direktivës "Për habitatet";
- Përforcuar kapacitetin e autoriteteve menaxhuese lidhur me fillimin e proceseve të menaxhimit në nivel ndërkufitar dhe monitorimin e popullatës së mishngrënësve të mëdhenj;

¹ Faqja e internetit e Komisionit Evropian: Platforma e BE-së për bashkekzistencën midis njerëzve dhe mishngrënësve të mëdhenj: http://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/coexistence_platform.htm

² Faqja e internetit e Komisionit Evropian: Platforma e BE-së për bashkekzistencën midis njerëzve dhe mishngrënësve të mëdhenj: nënfaqet e eventeve: http://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/events_sub_workshop_Budva.htm

³ Faqja e internetit e Komisionit Evropian: Deklarata e Budvës: http://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/181106Budva_LCP_Workshop%20statement-EN.pdf

⁴ Faqja e internetit e UBA-s: Beratungshilfeprogramme: <https://www.umweltbundesamt.de/en/topics/sustainability-strategies-international/cooperation-eeca-centraleastern-european-states/federal-environment-ministrys-advisory-assistance>

⁵ Të gjitha referencat ndaj Kosovës* në këtë dokument nuk cenojnë pozitën lidhur me statusin, dhe janë në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

- Përforcuar kapacitetin e grupeve të interesit nga sektorët përkatës që do të përfshihen në këto aktivitete, me synimin për të reduktuar konfliktet për praninë e mishngrënësve të mëdhenj.
- Ky raport përshkruan situatën në përfundim të periudhës fillestare të financimit dhe planet për bashkëpunime në të ardhmen, si dhe hapat e ardhshëm për ta çuar nismën më tej.

Analiza e situatës bazë

Raporti: *Mishngrënësit e mëdhenj në Alpet Dinarike: Menaxhimi, Monitorimi, Kërcënimet dhe Konfliktet*⁶ u hartua për të vlerësuar situatën në lidhje me statusin aktual të mishngrënësve të mëdhenj në Rajonin Dinarik. Informacioni u mbledh nëpërmjet 42 intervistave telefonike me ekspertë nga i gjithë rajoni, për të dhënë një përmbledhje të gjendjes në secilin shtet. Kjo u krahasua me literaturën ekzistuese dhe vlerësimet e mëparshme. Rezultatet u strukturuan sipas krahasimeve të menaxhimit kombëtar në këto tema: statusi i popullatës, legjislacioni dhe statusi i gjuetisë, monitorimi, planet e menaxhimit, kërcënimet kryesore ndaj popullatës së MM-ve, konfliktet kryesore, mbrojtja dhe kompensimi i bagëtive, nismat ekzistuese ndërkufitare.

Përmbledhja tregoi qartazi nevojën e ngritjes së kapaciteteve dhe të shkëmbimit lidhur me monitorimin dhe menaxhimin e MM-ve. Sllovenia dhe Kroacia kanë, deri diku (me disa përjashtime), një sistem të zhvilluar për planifikimin e menaxhimit dhe monitorimin. Fakti që planet e menaxhimit janë zhvilluar në disa shtete por kanë ngecur në fazën e autorizimit ose zbatimit, tregon se ekziston dëshira për koordinimin e qasjeve për ruajtjen dhe menaxhimin e MM-ve, por disa pengesa të tilla si aftësitë përkatëse, qartësitë rreth kompetencave, shqetësimet nëse kostot do të jenë shumë të larta dhe mungesa e vullnetit politik, kanë paraqitur vështirësi në zgjidhje.

Ky raport ishte i rëndësishëm për të ofruar një paraqitje të shkurtër mbi të cilën mund të bazohen diskutimet e ardhshme në kuadër të platformës. Intervistat qenë një burim i vlefshëm i informacionit fillestar. Ky informacion është plotësuar dhe verifikuar nëpërmjet diskutimeve në grup gjatë takimit të parë për platformën, duke i lejuar kështu pjesëmarrësit të arrijnë një dakordësi të përgjithshme mbi përmbajtjen dhe duke ofruar një bazë për diskutimet e tyre të ardhshme.

Platforma

Platforma në vetvete është një proces më i gjerë i shkëmbimit në lidhje me menaxhimin e MM-ve në të gjithë rajonin. Deri më sot, janë mbajtur dy **konferenca plenare të platformës** me kohëzgjatje 2-ditore në Lubjanë, Slloveni dhe Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, duke bërë bashkë përfaqësues të autoriteteve administrative (në veçanti ministritë e mjedisit dhe të bujqësisë) të të gjitha vendeve pjesëmarrëse, si dhe OJQ-të kombëtare dhe rajonale dhe përfaqësues të gjuetisë.

Krahas kësaj, ndërmjet takimeve të platformës, **takime të shkëmbimit tematik** në shkallë më të vogël kanë trajtuar pengesat dhe vështirësitë lidhur me menaxhimin e MM-ve, që hasen konkretisht në vendet përkatëse (dy janë mbajtur në Mostar, Bosnjë-Hercegovinë dhe në

⁶ <https://www.adelphi.de/en/publication/large-carnivores-dinarides-management-monitoring-threats-and-conflicts-background-report>

Parkun Kombëtar të Mavrovës, në Maqedoninë e Veriut). Gjithashtu, është mbajtur edhe një takim virtual midis përfaqësuesve qeveritarë për të diskutuar bazat e një marrëveshjeje për bashkëpunim të mëtejshëm.

Për të siguruar vazhdimësinë e aktiviteteve, një sekretariat (adelphi dhe Carnivora Magna) ishte përgjegjës për takimin e organizatave, përgatitjen e dokumenteve dhe për vazhdimësinë e diskutimeve midis grupeve të ndryshme të interesit. Një bord këshillimor i projektit, i përbërë nga ekspertë të rajonit dhe më gjerë, ka luajtur një rol të rëndësishëm për ofrimin e informacionit nga shtetet pjesëmarrëse, kontributin profesional në tema të ndryshme si dhe për kontaktet për proceset e ndryshme të platformës.

Pra, platforma ekziston por ka nevojë të përforcojë proceset e saj për një të ardhme afatgjatë. Puna e platformës ka përparuar në dy fusha veprimtarie:

1. Kontrolle praktike të aktiviteteve, ku mund të bashkëpunojnë qeveritë dhe administratat
2. Puna për një marrëveshje zyrtare bashkëpunimi (marrëveshje ndërkombëtare ligjërisht të detyrueshme ose jo të detyrueshme midis shteteve pjesëmarrëse).

Është e qartë se fusha e dytë e veprimtarisë kërkon kohë shtesë për diskutime midis qeverive pjesëmarrëse, konsultime të mëtejshme me ekspertë ligjorë dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare si dhe ekzaminime të modeleve të ndryshme të punës. Në të njëjtën kohë, fusha e parë e veprimtarisë është duke avancuar, në veçanti duke marrë në konsideratë ndërthurjet me projektet e tjera dhe duke identifikuar burimet e financimit për administratorët për të përcaktuar proceset e nevojshme, për të ngritur kapacitetet dhe për të mësuar nga njëri-tjetri.

Aktivite për bashkëpunimin qeveritar/administrativ

Në takimin e dytë të platformës, pjesëmarrësit diskutuan lidhur me të tre fushat kryesore, ku bashkëpunimi midis shteteve shihet si thelbësor dhe ku nevojitet ngritja e kapaciteteve në bashkëpunim me qeveritë përgjegjëse dhe administratorët. Meqenëse burimet janë të pakta për të trajtuar temën dhe ka pak staf të dedikuar dhe të kualifikuar, do të nevojiten kontribute shtesë për të mbështetur këto aktivitete nga projektet ekzistuese dhe të reja. Roli i platformës është që të shkëmbejë informacion rreth aktiviteteve në vazhdim dhe të maksimizojë potencialin e tyre për tu zhvilluar më gjerësisht në rajon. Më poshtë gjendet një përmbledhje e shkurtër e temave të diskutuara në takimet e platformës.

Planifikimi i menaxhimit

Planifikimi i menaxhimit është hapi i parë thelbësor për të kuptuar dhe për të unifikuar të gjitha aktivitetet përkatëse për mishngrënësit e mëdhenj. Për planifikimin në nivel ndërkufitar disponohen udhëzime ndërkombëtare⁷. Anëtarët e platformës nxisin ekspertët nga çdo shtet që të punojnë së bashku në përcaktimin e një procedure për zhvillimin dhe përmbajtjen e planit, e cila mund të përdoret si bazë për planifikimin kombëtar.

Planifikimi kombëtar duhet të përfshijë një grup kryesor ekspertësh për të krijuar strukturën e planit. Megjithatë, ky duhet të jetë një proces pjesëmarrës (duhet të krijohet një platformë kombëtare për të diskutuar dhe përshtatur planin). Planet duhet të marrin në konsideratë

⁷ Eg Boitani et al. (2015) Masat kryesore për popullatën e mishngrënësve të mëdhenj në Evropë: https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/key_actions_large_carnivores_2015.pdf

aktivitetet në shtetet fqinje. Ato duhet të vlerësohen në periudha të caktuara dhe të përshtaten nëse është e nevojshme.

Monitorimi

Pjesëmarrësit e platformës pranojnë se monitorimi në shumë vende nuk është i mjaftueshëm dhe se shifrat e popullatës janë dhënë me përafërsi. Metodologjia Scalp është një qasje e pranuar gjerësisht, e cila integron një sërë metodash të nevojshme anketimi për të krijuar një skemë monitorimi. Ajo mund të zbatohet në të gjithë rajonin. Institucione të ndryshme do të jenë përgjegjëse në shtete të ndryshme për të ngritur sistemet e monitorimit. Grupet e interesit duhet të asistojnë në mbledhjen e të dhënave. Baza e të dhënave për të shkëmbyer informacion midis shteteve duhet të krijohet në bazë të modeleve ekzistuese. Raportet kryesore mbi monitorimin duhet të prodhohen çdo 6 vjet, sipas kërkesave të raportimit të Direktivës "Për habitatet".

Konektiviteti

Fragmentimi i habitateve shkaktohet nga ndërtimi i komponentëve të ndryshëm infrastrukturorë, duke përfshirë rrugët e transportit (rrugët dhe hekurudhat, tubacionet, linjat e energjisë elektrike); strukturat e prodhimit të energjisë (energji hidrike, eolike dhe diellore); infrastruktura turistike dhe sportive, të cilat lejojnë akses të shtuar; si dhe rrethimi për të kontrolluar emigrimin e njerëzve. Konektiviteti kërkon përfshirjen e grupeve të reja të interesit si për shembull planifikuesit dhe personat përgjegjës për ndërtimin e rrugëve, pyjeve, turizmin, dhe punimet në miniera. Planet e menaxhimit të MM-ve duhet të marrin parasysh konektivitetin dhe të përfshijnë hartëzimin e korridoreve. Bashkëpunimi ndërkuftar është veçanërisht i nevojshëm në këtë fushë.

Temat e tjera të trajtuara:

Reduktimi i sulmeve ndaj bagëtive

Ndërsa kjo temë trajtohet kryesisht në nivel kombëtar, vetëm disa vende në rajon kanë skema të mira monitorimi, mbrojtjeje ose kompensimi dhe për këtë arsye, shkëmbimi i qasjeve shihet si thelbësor.

Reduktimi i konflikteve të drejtpërdrejta me arinjtë (dëmet ndaj pronës/aksidentet/sulmet)

Ekziston mundësia që vendet të mësojnë nga qasjet e njëra-tjetrës, veçanërisht për sa i përket caktimit të Ekipeve të Ndërhyrjes për Arinjtë. Ky konsiderohet si një hap i parë i rëndësishëm, por mjaft i thjeshtë, për të reduktuar konfliktin.

Angazhimi i grupeve të interesit

Kjo është një temë e rëndësishme për strukturën e platformës. Kjo platformë synon të integrojë gradualisht në procese grupet e interesit. Në të njëjtën kohë, ekziston mundësia për vendet pjesëmarrëse që të mësojnë nga njëra-tjetra dhe nga eksperiencat e BE-së për angazhimin e grupeve të interesit në nivel kombëtar dhe në nivel vendor.

Në takimin e dytë të platformës, u organizua një seancë me vëmendje të veçantë në angazhimin e gjuetarëve. Gjuetarët janë një grup interesi i rëndësishëm në rajon pasi ata janë të shumtë dhe aktivë në terren, në zonat ku janë të pranishëm MM-të. Në shumë shtete, ata kontribuojnë në skemat ekzistuese të anketimit, ndërkohë që përfshirja dhe kontributi i tyre nevojitet gjithashtu për skema më të sofistikuar monitorimi. Në disa shtete, gjuetarët janë bashkëpunëtorë të përkushtuar të shkencëtarëve, organizatave të mbrojtjes dhe të qeverisë,

ndërkohë që në rajone të tjera, marrëdhëniet janë më të tensionuara. Përfshirja e gjuetarëve varet nga interesi personal por gjithashtu nga përfitimet duke përfshirë mundësinë për gjuetinë e MM-ve, përfitimet nga lejimi i gjuetisë ose përfshirja në lloje të tjera të turizmit ekologjik.

Marrëveshja për bashkëpunim të vazhdueshëm

Struktura e mundshme e një marrëveshjeje u shqyrtua gjatë një takimi virtual të posaçëm dhe u shtjellua më tej në takimin e dytë të platformës. Më poshtë jepet teksti aktual, i cili ka nevojë për modifikim të mëtejshëm nëpërmjet diskutimeve me shtetet përkatëse dhe me ekspertët ligjor.

Titulli

Marrëveshje ndërkombëtare që mbështet bashkekzistencën me mishngrënësit e mëdhenj, si dhe mbrojtjen dhe menaxhimin e tyre në nivel popullate në rajonin Dinarik-Balkan-Malet e Pindit

Parathënie

Në parathënie duhet të përmenden aspektet e mëposhtme.

Të merret në konsideratë që rajoni Dinarik-Balkan-Malet e Pindit është një nga rajonet me larminë më të madhe biologjike në Evropë dhe habitat i popullatave të mëdha të mishngrënësve të mëdhenj.

Të kuptohet që bashkëpunimi ndërkufitar është thelbësor, ndërkohë që një qasje e popullsisë ndaj menaxhimit të mishngrënësve të mëdhenj është e nevojshme për të koordinuar dhe përqendruar masat e ndryshme vendore brenda një kuadri më të gjerë.

Rikujtojmë në këtë kontekst, planin e veprimit: *Masat kryesore për popullatën e mishngrënësve të mëdhenj në Evropë.*

Të kuptohet se menaxhimi i mishngrënësve të mëdhenj duhet të caktohet nga prova të sigurta shkencore, duke integruar shkencat e natyrës dhe ato sociale, duke përdorur të dhënat më të mira të disponueshme dhe të besueshme.

Të njihet rëndësia, në këtë kontekst, e zbatimit të plotë të marrëveshjeve ndërkombëtare përkatëse mjedisore të tilla si Konventa "Për ruajtjen e faunës dhe florës së egër dhe habitateve natyrore të Evropës" (Konventa e Bernës), Konventa "Për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër" (CITES) dhe Direktiva e BE-së "Për Habitatet".

Të mbahet parasysh që konsideratat socio-ekonomike dhe kulturore si dhe shqetësimet në nivel rajonal dhe vendor duhet të njihen në mënyrë që të përmirësohet bashkekzistenca midis njerëzve dhe mishngrënësve të mëdhenj.

Të njihet vizioni dhe parimet e përbashkëta të dakordësuara në Seminarin Rajonal të Platformës së BE-së për Mishngrënësit e Mëdhenj, mbajtur në Budva⁸ "Për të mbështetur shkëmbimin e informacionit midis shteteve dhe për të nxitur praktikatat e menaxhimit të cilat promovojnë bashkekzistencën si dhe minimizojnë dhe, aty ku është e mundur, gjejnë zgjidhje për konfliktet ndërmjet interesave njerëzore dhe pranisë së specieve të mëdha

⁸ https://ec.europa.eu/environment/nature/conservation/species/carnivores/pdf/181106Budva_LCP_Workshop%20statement-EN.pdf

mishngrënëse në rajonin Dinarik-Ballkan-Malet e Pindit, duke shkëmbyer njohuri dhe duke punuar së bashku në një mënyrë të hapur, konstruktive dhe me respekt të ndërsjellë.”

Të pranohet vlera e mbështetjes dhe bashkëpunimit me marrëveshjet rajonale si Konventa "Për mbrojtjen e Alpeve" dhe Konventa "Për mbrojtjen e Karpateve" për shkëmbim, koordinim dhe menaxhim ndërkufitar duke përfshirë grupet e tyre të punës dhe planin e veprimit veçanërisht për mishngrënësit e mëdhenj.

Synimi gjithëpërfshirës

Marrëveshja e përgjithshme për qëllimin e mëposhtëm

Ndjekja e një politike gjithëpërfshirëse dhe bashkëpunimi për ruajtjen ndërkufitare dhe menaxhimin e qëndrueshëm të specieve të mëdha mishngrënëse në rajonin Dinarik-Ballkan-Malet e Pindit me synimin, ndër të tjera, të arritjes së statusit të favorshëm të ruajtjes, si dhe të ruajtjes së vlerave natyrore dhe trashëgimisë kulturore.

Mbulimi gjeografik

Mbulimi u diskutua. Mënyra për të bërë ndryshime në zonën e mbuluar ishte më e debatueshme.

Marrëveshja mbulon gamën e popullatës së ariut të murrmë të rajonit Dinarik-Malet e Pindit, popullatën e ujërve të rajonit Dinarik në Ballkan, dhe popullatën e rrëqebullit në rajonin Dinarik dhe Ballkan në shtetet nënshkruese të përcaktuara nga palët.

Secila palë është përgjegjëse për përcaktimin e mbulimit gjeografik brenda shtetit të saj dhe për komunikimin e zonës pranë [organi kompetent]. Secila palë mund të zgjasë zbatimin e kësaj marrëveshjeje për pjesë shtesë të territorit të saj kombëtar duke bërë një deklaratë pranë [organi kompetent].

Fushat e bashkëpunimit

Për të përmbushur objektivin e marrëveshjes, palët duhet të marrin masat e duhura në fushat e mëposhtme siç janë identifikuar në masat kryesore për popullatën e mishngrënësve të mëdhenj në Evropë:

- Ngritja e kapaciteteve institucionale dhe zbatimi i ligjit
- Planifikimi i menaxhimit
- Standardizimi i monitorimit
- Përmirësimi i bashkekzistencës
- Përmirësimi i lidhjes ekologjike

Plani i punës dhe planet e veprimit

Plani i punës dhe i veprimit duhet të miratohen pas diskutimit të mëtejshëm mbi llojin e marrëveshjes dhe masave më të nevojshme. Struktura e mëposhtme ishte objekt diskutimi.

Për të mbështetur zbatimin e këtyre masave, palët bien dakord:

- Të caktojnë prioritetet specifike kombëtare bazuar në masat e përfshira në këtë marrëveshje
- Të hartojnë një [plan dy vjeçar] që korrespondon me kohëzgjatjen e platformës
- Të hartojnë një plan pune disaveçar për rinovimin e platformës [çdo 6 vjet]

- Të hartojnë plane specifike veprimi/protokolle për temat e mësipërme, siç kërkohet për të përmbushur synimin gjithëpërfshirës
- Të ndajnë informacion dhe të bashkëpunojnë siç përshkruhet më poshtë
- Të krijojnë projekte të përbashkëta për të mbështetur zbatimin për sa më sipër

Parimet e bashkëpunimit

Palët bien dakord të bashkëpunojnë dhe të ndajnë përvojat në mënyrë të hapur dhe mbështetëse duke respektuar parimet e mëposhtme:

- parimet e parandalimit
- pjesëmarrja publike dhe përfshirja e palëve të interesit
- bashkëpunimi ndërkufitar
- planifikimi dhe menaxhimi i integruar i burimeve tokësore dhe ujore
- një qasje programore, dhe
- qasja ndaj ekosistemit

Zbatimi

Seksioni i zbatimit duhet të përshtatet me llojin e marrëveshjes. U diskutua struktura e mëposhtme, terminologjia e përdorur mund të ndryshohet.

- Palët në komisionin e përhershëm
- Kryetar(ë) nga palët (shtetet) ose zëvendëskryetarët
- Sekretariati
- Bordi Këshillimor
- Procesi i vendimmarrjes

Raportimi dhe Financimi

Ky seksion ka nevojë për diskutim të mëtejshëm. Do të analizohen disa modele të ndryshme financimi dhe do të përlogariten kostot.

Kontributet financiare dhe burimet e jashtme të financimit

Bashkëpunim me aktorë të tjerë/aktivitetet në rajon

Për të vazhduar punën e platformës do të nevojitet bashkëpunim me një sërë aktorësh në rajon. Më poshtë jepet një listë fillestare me bashkëpunëtorët potencialë në të ardhmen. Kjo do të zgjerohet gjatë rrjedhës së takimeve të ardhshme të platformës dhe me kontributin e pjesëmarrësve dhe të bordit këshillimor.

| Organizata | Bashkëpunimi i deritanishëm | Planet e ardhshme |
|--------------------------------------|-----------------------------|---|
| Konventa "Për mbrojtjen e Alpeve" | Ka marrë pjesë në takime | Të diskutojë llojin e marrëveshjes dhe të ofrojë këshilla |
| Konventa "Për mbrojtjen e Karpateve" | Ka marrë pjesë në takime | Të diskutojë llojin e marrëveshjes dhe të ofrojë këshilla, mundësi për takim të përbashkët në Serbi |

| | | |
|--|--|---|
| WWF Adria | Në bordin këshillimor | Të shikojë për ndërthurje në aktivitete, financim i përbashkët i aktiviteteve |
| Euronatur | Ka mbështetur takimin e parë të platformës, shumë projekte në rajon | Të shikojë për ndërthurje në aktivitete, financim i përbashkët i aktiviteteve |
| Platforma e BE-së për Mishngrënësit e Mëdhenj | Përfaqësuesit morën pjesë në takime, një sekretariat i përbashkët, nisma filloi me takimin rajonal të platformës | Mundësi për takime të përbashkëta në të ardhmen |
| Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) | Përfshirja e NEMM-së/anëtarë të grupit të specialistëve të specieve | Të diskutojë me zyrën rajonale mbi kontributin dhe bashkëpunimin e ardhshëm |
| Këshillit Ndërkombëtar për lojë dhe mbrojtje të kafshëve të egra (CIC) | Në bordin këshillimor | Të konsultohet për bashkëpunime të ardhshme |

Shtojca 1. Anëtarët e Bordit Këshillimor

| Emri | Organizata |
|------------------------|--|
| Rok Černe | Shërbimi Pyjor Slloveni |
| Snježana Malić-Limari | WWF Adria |
| Duško Čirović | Fakulteti i Biologjisë, Universiteti i Beogradit, Serbi |
| Jelena Marojević Galić | Parqet Dinarike, Mali i Zi |
| Aleksandër Trajçe | Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA) |
| Haris Hadžihajdarević | Administrata e Parkut Kombëtar Una, Bosnjë-Hercegovina |
| Dejan Radošević | Instituti Republikan për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, Historike dhe Natyrore, Republika Srpska |
| Vlatko Trpeski | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MoEPP), Departamenti për Natyrën në Administratën e Mjedisit, Maqedonia e Veriut |
| Valeria Salvatori | Instituti i Ekologjisë së Aplikuar, Itali |
| Klaus Hackländer | Instituti i Biologjisë së Kafshëve të Egra dhe Menaxhimit të Kafshëve të Gjetisë, Departamenti i Biologjisë së Integruar dhe Kërkimit të Biodiversitetit, Universiteti i Burimeve Natyrore dhe Shkencave të Aplikuara, Vjenë |

Shtojca 2. Pjesëmarrësit në takimet e platformës

| Shteti | Mbiemri | Emri | Pozicioni | Institucioni | Pjesëmarrja në takim* | | | |
|--------------------|------------|-------------|--|--|-----------------------|------|------|------|
| | | | | | TP 1 | TP 2 | TT 1 | TT 2 |
| Greqi | Agapitou | Kalomoira | Forester | Ministry of Environment and Energy | x | | | |
| Maqedonia e Veriut | Aleksandar | Trajchovski | | Faculty of veterinary | | | | x |
| Maqedonia e Veriut | Aleksandar | Pavlov | | Macedonian Ecological Society | | | | x |
| Maqedonia e Veriut | Aleksandar | Tosveski | | Food and veterinary agency | | | | |
| Maqedonia e Veriut | Ana | Colovic | | WWF Adria/Ekosvest | | | | x |
| Maqedonia e Veriut | Andon | Bojadzi | | NP Galicica | | | | x |
| Maqedonia e Veriut | Andrej | Gonev | | Macedonian Ecological Society | | | | x |
| Maqedonia e Veriut | Anela | Stavrevska | | NATURA MK | | | | x |
| Bosnjë-Hercegovinë | Bahor | Muharem | Department of Forest Management and Hunting | Ministry of Agriculture, Water Management and Forestry of the Federation of Bosnia and Herzegovina | x | | x | |
| Kroaci | Bišćan | Antonija | Member of the National Brown Bear Management Committee in Republic of Kroaci | State inspectorate | | x | | |

| | | | | | | | | |
|--------------------|-------------|--------------|---|---|---|---|--|---|
| Mali i Zi | Brajovic | Tamara | General Director of the department for nature | Ministry of Environment | | x | | |
| Kroaci | Burčul | Barbara | Senior expert advisor | Ministry of Economy and Sustainable Development | | x | | |
| Maqedonia e Veriut | Cane | Petevski | | NP Mavrovo | | | | x |
| Kosovën * | Çavdarbasha | Linda | Deputy Minister of Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure | Ministry of Environment | | x | | |
| Slloveni | Černe | Rok | Head of large carnivore project team | Sllovenin Forest Service | x | x | | x |
| Belgjika | Cipriani | Marco | Policy Office | European Commission | | x | | |
| Serbi | Ćirković | Bratislav | President | Serbian Hunting Association | x | | | |
| Serbi | Cirovic | Dusko | Associate professor | University of Belgrade, Faculty of Biology | | x | | |
| Serbi | Ćirović | Duško | Assistant Professor | Faculty of Biology, University of Belgrade | x | | | |
| Shqipëri | Çobanaj | Antonela | Project Expert at National Agency of Protected Areas | National Agency of Protected Areas | x | x | | |
| Maqedonia e Veriut | Daniela | Kamceva | | MOEPP | | | | x |
| Maqedonia e Veriut | Darko | Blinkov | | State environmental Inspectorate | | | | x |
| Slloveni | Debeljak | Nika | Co-chair EUSALP | Institute for nature conservation of Slloveni, | | x | | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Dedić | Denisa | Coordinator | Canton Sarajevo | x | | | |
| Maqedonia e Veriut | Dejan | Dimidzievski | | NP Galicica | | | | |

| | | | | | | | | |
|--------------------|-----------------|-----------------|---|---|---|---|---|---|
| Maqedonia e Veriut | Dime | Melovski | | Macedonian Ecological Society | | | | x |
| Bullgari | Dineva | Nikoleta | Senior expert | Department of Hunting, Executive Forest Agency | x | | | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Dragomirović | Aleksandra-Anja | Vice-President | Center for Environment | x | x | | |
| Serbi | Ducic | Jelena | Head of department for biodiversity | Ministry of Environmental Protection | | x | | |
| | Ekrem | Veapi | | NP Marovo | | | | x |
| Bullgari | Galitionova | Radostina | Chief expert at Biodiversity Department | Ministry of Environment and Water, National Nature Protection Service Directorate | x | x | | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Grabovac | Zlata | Expert on international cooperation on biodiversity | Federal Ministry of Environment and Tourism | x | | | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Gušević | Naida | Coordinator | Canton Sarajevo | x | | | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Hadžihajdarević | Haris | Administration | National Park Una, Bosnia and Herzegovina | x | x | x | |
| Kosovën * | Hetemaj | Ismail | Chief of the Division for the Nature Protection | Department of Environmental and Water Protection | | x | | |
| Kroaci | Huber | Duro | Director | Carnivora Magna | x | x | x | x |
| Siloveni | Humar | Maja | Nature Conservation Division | Ministry of the Environment and Spatial Planning | x | | | |
| Maqedonia e Veriut | Ibrahim | Dehari | | NP Shara Mountain | | | | x |

| | | | | | | | | |
|--------------------|--------------|-------------|---|--|---|---|---|--|
| Montenegro | Jankovic | Milos | Head of the Hunting Department | Ministry of Agriculture, Forestry and Water Management | x | | | |
| Montenegro | Janković | Miloš | Head of the Directorate for Hunting | Ministry of Agriculture | | x | | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Jasmin | Omeragić | Prodekan za financije | Veterinarski fakultet UNSA | | | x | |
| Kroaci | Jeremić | Jasna | Senior advisor - specialist | Institute for Environment and Nature Protection, Ministry of Economy and Sustainable Development | | x | x | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Kadic | Kemo | Head of Department of Forest Management and Hunting | Ministry of Agriculture, Water Management and Forestry of the Federation of Bosnia and Herzegovina | x | | x | |
| Gjermani | Kehl | Jan Philipp | Project Leader | Euronatur | | x | | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Klarić Soldo | Darinka | assistant | Veterinary Faculty UNSA | x | | x | |
| Maqedonia e Veriut | Kristijan | Cokoski | | Faculty of Forestry | | | | |
| Austri | Kuras | Klaudia | Carpathian Convention Coordination Expert | Carpathian Convention | x | | | |
| Gjermani | Leschinski | Lisa | Project Leader Lynx for EuroNatur Foundation | Euronatur | | x | | |
| Kroaci | Malić-Limari | Snježana | Interim Wildlife Program Manager | WWF Adria | x | x | | |

| | | | | | | | | |
|--------------------|-----------------|------------|--|--|---|---|---|---|
| Montenegro | Maraš | Arina | Head Of Division For Protected Areas | Ministry of Ecology, Spatial Planning and Urbanism | x | | | |
| Maqedonia e Veriut | Mare | Basova | | National forest company | | | | x |
| Montenegro | Marojevic Galic | Jelena | Communications officer | Parks Dinarides, Montenegro | x | x | | |
| Gjermani | Marsden | Katrina | Senior manager biodiversity | adelphi | x | x | | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Mirjana | Milićević | | PMF, Mostar, FZO | | | x | |
| Serbi | Momirov | Radislav | Advisor | Ministry of Environmental Protection | x | | | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Muhamed | Brka | Dekan | Poljoprivredno prehrambeni fakultet UNSA | | | x | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Mujaković | Zineta | Head of Department for Biodiversity and Landscape Protection | Federal Ministry of Environment and Tourism | x | | x | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Naida | Kapo | | VF, UNSA | | | x | |
| Austri | Novljan | Živa | Project Officer | Permanent Secretariat of the Alpine Convention | x | | | |
| Gjermani | Otto | Sonja | Project Coordinator, Advisory Assistance Programme | German Environment Agency | x | x | | |
| Slloveni | Pagon | Nives | | Slloveni Forest Service | | x | | |
| Montenegro | Perovic | Aleksandar | Head of large carnivore | Center for Protection and Research of Birds | | x | | |

| | | | | | | | | |
|--------------------|---------------|------------|---|--|---|---|---|---|
| | | | conservation program | | | | | |
| Serbi | Radosavljevic | Aleksandar | Head of Department for Planning and Sustainable Management in Hunting | Ministry of Agriculture, Forestry and Water Management | x | x | | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Radošević | Dejan | Head of Biodiversity Section | Republican Institute for the Protection of Cultural, Historical and Natural Heritage, Republic of Srpska | x | x | x | |
| Kroaci | Reljic | Slaven | Project officer | Carnivora Magna | x | x | | x |
| Italy | Salvatori | Valeria | General Secretary | Istituto di Ecologia Applicata | | x | | |
| Maqedonia e Veriut | Samir | Ajdini | | NP Mavrovo | | | | x |
| Maqedonia e Veriut | Sasha | Jovanovic | | Ministry of agriculture, forestry, and water economy | | | | x |
| Maqedonia e Veriut | Sasko | Jordanov | | MOEPP | | | | x |
| Gjermani | Schmidt | Julia | Manager Business Development | adelphi | x | x | | |
| Kroaci | Sindičić | Magda | Associate professor | Faculty of Veterinary Medicine University of Zagreb | | x | | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Škapur | Vedad | Professor | Faculty of Agriculture and Food Sciences, University of Sarajevo | x | x | x | |

| | | | | | | | | |
|--------------------|-----------|-------------|---------------------------|---|---|---|---|---|
| Kroaci | Solić | Andrea | Project leader | Carnivora Magna | x | x | x | x |
| Serbi | Spasić | Marija | Expert | Serbian Hunting Association | x | | | |
| Maqedonia e Veriut | Stefan | Tekovski | | Faculty of veterinary | | | | |
| Gjermani | Steyer | Katharina | Scientific staff | German Federal Agency for Nature Conservation | x | | | |
| Albania | Trajce | Aleksander | Executive Director | Protection and Preservation of Natural Environment in Albania | x | | | |
| Albania | Trajçe | Aleksandër | Researcher | PPNEA | | x | | |
| North Macedonia | Trpeski | Vlatko | Head of nature department | Ministry of Environment and Physical Planning | | x | | x |
| Albania | Vardhami | Edit | Expert | Ministry of Tourism and Environment | | x | | |
| Maqedonia e Veriut | Vlatko | Aleksovski | | National Hunting organization | | | | x |
| Maqedonia e Veriut | Vojo | Gogovski | | Ministry of agriculture, forestry, and water economy | | | | x |
| Bullgari | Zlatanova | Diana | Associate professor | Faculty of Biology, Sofia University | | x | | |
| Maqedonia e Veriut | Zoran | Projchevski | | NP Pelister | | | | |
| Bosnjë-Hercegovinë | Zubić | Goran | Assistant Minister | Ministry of Agriculture, Forestry and Water Management | x | | x | |

| | | | | | | | |
|--------|--------|----------|---|-------------------------|--|---|---|
| Kroaci | Žuglić | Tomislav | Head of Service for hunting grounds and game management | Ministry of Agriculture | | x | x |
|--------|--------|----------|---|-------------------------|--|---|---|

**TP 1 = Takim plenar në Lubjanë, Slloveni; TP 2 = Takim plenar në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë TT 1 = Takim tematik në Mostar, Bosnjë-Hercegovinë; TT 2 = Takim tematik në Parkun Kombëtar të Mavrovës, Maqedonia e Veriut*